



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 3: Statistikat Ekonomike

Statistikat e PRODCOM-it 2018



AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 3: Statistikat Ekonomike

Statistikat e PRODCOM-it 2018



Botuesi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Data e botimit: Dhjetor, 2019

© : Agjencia e Statistikave të Kosovës

Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.

Informata të shumta janë në dispozicion në internet,
ku mund të qaseni përmes veb-faqes së ASK-së
në internet <http://ask.rks-gov.net/>

P a r a t h ë n i e

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka përgatitur publikimin e rezultateve të Statistikave të prodhimit industrial apo PRODCOM - it për vitin 2018.

Duke filluar nga viti 2016, e këndej ky hulumtim është pjesë përbërëse e Programit statistikor të ASK - së dhe bazohet në deklaratimet e ndërmarrjeve. Ky hulumtim publikohet në baza të rregullta vjetore.

Rezultatet e këtij hulumtimi paraqesin ecurinë e prodhimit industrial në ekonominë e Kosovës. Gjithashtu këto rezultate përdoren për nevoja të përpilimit të llogarive kombëtare dhe janë burim i rëndësishëm në përpilimin e Bruto Produktit Vendor me qasjen e prodhimit dhe shpenzimeve në baza tremujore.

Publikimi vjetor mbi statistikat e PRODCOM - it përmban të dhëna gjithëpërfshirëse dhe të detajuara vjetore nga fusha e statistikave të prodhimit industrial. Të dhënat e prezantuara janë grumbulluar përmes hulumtimit vjetor PRODCOM mbi prodhimin industrial PRODCOM për 2018.

Ky publikim mund t'u nënshtrohet korrigjimeve eventuale për shkak të aplikimit të metodologjive të reja sipas EUROSTAT-it.

Publikimin e përgatiten:

Ilir T. Berisha - Drejtor i departamentit
Ismail Sahiti - Shef i divizionit,
Hysni Elshani - Shef i sektorit,
Muhamet Kastrati - Specialist i TI - së për RSB,
Bekim Bojku - Zyrtar,
Qendresa Shala - Zyrtare e statistikave të transportit dhe telokuminikimi
Dafina Kumnova – Zyrtare e statistikave te industrise

(E - mail: economic@rks-gov.net)

Prishtinë, Dhjetor, 2019

Kryeshef Ekzekutiv i ASK-së,
z. Isa Krasniqi

Simbolet dhe shkurtesat

ASK	-	Agjencia e Statistikave të Kosovës
KVE	-	Klasifikimi i veprimtarive ekonomike
ATK	-	Administrata Tatimore e Kosovës
ARBK	-	Agjencioni i Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë
RSB	-	Regjistri Statistikor i Bizneseve
PRODCOM	-	Statistikat e prodhimit industrial

Simbolet

:	-	Mungojnë të dhënat
n/a	-	Nuk aplikohet

Përmbajtja

	Faqe
1 Objektivi, metodologjia dhe shtrirja e anketës.....	4
1.1 Objektivi.....	4
1.2 Metodologjia dhe shtrirja e anketës.....	4
1.3 Korniza për mostër dhe përzgjedhja mostrës.....	5
1.4 Procedurat e mbledhjes (grumbullimit) së të dhënave.....	5
2 Definicione, përkufizime dhe treguesit themelorë.....	6
2.1 Definicione dhe përkufizime.....	6
2.2 Treguesit themelorë.....	7

1 Objektiv, metodologjia dhe shtrirja e anketës

1.1 Objektiv

Objekt i përfshirjes së PRODCOM-it dhe njësi raportuese të janë të gjitha shoqëritë tregtare dhe persona tjerë juridik me mbi 10 të punësuar, të cilat janë marrë me aktivitet të prodhimit industriale apo kanë ushtruar shërbime industriale për nevoja vetanake apo në bazë të kontratës, gjatë vitit referues sipas definicioneve të sektorëve industriale B, C dhe E (vetëm dega 36) të NVE së. Anketa synon t'i plotësojë kërkesat për informacione më të plota statistikore në kushtet e ekonomisë së tregut dhe ofron të dhëna mbi aktivitetet ekonomike të ndërmarrjeve në sektorin e prodhimit industrial.

1.2 Metodologjia dhe shtrirja e anketës

Ky publikim përmban të dhëna të detajuara mbi prodhimin industrial në nivel të vendit. Nocioni apo termi "industri" është definuar me prodhimet (dhe shërbimet) nga sektori B, C dhe E (vetëm grupi 36) sipas NVE Rev.2. (Rregullorja 02/2011). Ky definicion mbi industrinë është i harmonizuar me definicionin i cili shfrytëzohet në BE mbi statistikën e PRODCOM-it.

Burimet dhe metodat e grumbullimit të të dhënave: Të dhënat e publikuara në këtë publikim janë rezultat i hulumtimit statistikor PRODCOM mbi prodhimin industrial për vitin referues 2018. Është realizuar nga ana e ASK-së në bazë të ligjit mbi statistikën zyrtare, Planit vjetor të ASK-së, mbi realizimin e hulumtimeve statistikore për vitin 2018.

Objekt i hulumtimit të PRODCOM - it për 2018 është prodhimi i mundshëm dhe i realizuar i produkteve industriale, sasia dhe vlera e shitur e prodhimit industrial.

Nuk përfshihet prodhimi i cili është shfrytëzuar apo do të shfrytëzohet për përpunim të mëtejshëm në njësi lokale të cilat i përkasin të njëjtit biznes (njësi raportuese). Përfshin prodhimin e realizuar për nevoja

vetanake si dhe prodhimin në bazë të kontratës me porositësin. Të dhënat mbi prodhimin janë prezantuar në nivel të prodhimeve industriale dhe listës së produkteve, në bazë të përqindjes.

Të dhënat për përpunim janë grumbulluar në mbarë territorin e vendit. Të gjitha të dhënat e PRODCOM - it i referohen periudhës njëvjeçare duke filluar nga 1.01.2018 deri më 31.12.2018. Janë prezantuar vetëm të dhënat mbi prodhimin e realizuar brenda territorit të Republikës së Kosovës.

Nuk është përfshirë prodhimi i cili është realizuar jashtë territorit të Republikës së Kosovës në emër të njësisive lokale apo bizneseve.

Në vazhdim të tekstit janë dhënë shpjegime metodologjike të posaçme dhe u sugjerohen të gjithë shfrytëzuesve si një mjet i domosdoshëm për interpretim korrekt të të dhënave dhe shfrytëzimin e tyre.

Treguesit e PRODCOM-it mbi prodhimin industrial.

1.3 Korniza për mostër dhe përzgjedhja mostrës

Për krijimin e kornizës së mostrës janë shfrytëzuar të dhënat nga regjistri statistikor i bizneseve (RSB). Të gjitha ndërmarrjet që kanë deklaruar njërin nga tatimet gjatë viteve referuese për vitet paraprake janë konsideruar aktive.

Përzgjedhja e mostrës është bërë në bazë të kriterit ku janë përfshirë të gjitha ndërmarrjet që përfaqësojnë 80% të qarkullimit për aktivitetin përkatës të NVE Rev.2.

1.4 Procedurat e mbledhjes (grumbullimit) së të dhënave

Në mbledhjen e të dhënave ne kemi aplikuar metodat të cilat i kemi konsideruar më efikase për kushtet dhe rrethanat në vendin tonë.

Anketimi i bizneseve të përfshira në mostër është kryer me metodën e intervistimit të drejtpërdrejt në biznese përmes pyetësorëve.

Në raste të caktuara kur intervista ka qenë e pamundur të realizohet drejtpërdrejt andaj pyetësorët u janë lënë personave përgjegjës pranë ndërmarrjeve me qëllim të plotësimit të tyre dhe pas disa ditësh të njëjtit të plotësuar janë marrë nga anketuesit.

2 Definicione, përkufizime dhe treguesit themelorë

2.1 Definicione dhe përkufizime

PRODCOM është emërtim për statistika prodhuese mbi prodhimin industrial të BE-së të definuar me Rregulloren No.3924/91. Shkurtesa është derivuar nga emërtimi në gjuhën frenge "Production Communautaire" (Prodhimi në Bashkësi).

Lista e PRODCOM - është një listë e produkteve, të mirave dhe shërbimeve të cekura në emërtimet e hulumtimit të PRODCOM.

Produkti – prodhimi

Prodhimi është si rezultat i një aktiviteti ekonomik. Shfrytëzohet si nocion për produktet të cilat kanë dimension fizik edhe për shërbimet. Sipas konceptit të hulumtimit PRODCOM-it sipas listës së produkteve të BE-së. Sipas nocionit të prodhimit të gatshëm konsiderohet çdo produkt i cili gjatë procesit të prodhimit industrial ka arritur një nivel të caktuar të përpunimit, dhe sipas listës së produkteve është e kodifikuar me një kod të veçante.

Konceptet dhe definicionet e shfrytëzuara në hulumtimin e PRODCOM-it të Republikës së Kosovës janë të harmonizuara me hulumtimin e PRODCOM - it të BE - së.

Ndërmarrja është njësia më e vogël e kombinimit të njësisë legale me njësinë e prodhimit të produkteve ose shërbimeve e cila ka pavarësi në vendim-marrje, sidomos për përdorimin e burimeve të saj materiale e monetare. Një ndërmarrje mund të ushtrojë një ose disa aktivitete ekonomike.

Ndërmarrje aktive – konsiderohen vetëm ato ndërmarrje që kanë deklaruar njërin nga tatimet apo ndonjë të punësuar për vitin referues. Ndërmarrja është njësia më e vogël e kombinimit të njësisë legale me njësinë e prodhimit të produkteve ose shërbimeve e cila ka pavarësi në vendim-marrje, sidomos për përdorimin e burimeve të saj materiale e monetare. Një ndërmarrje mund të ushtrojë një ose disa aktivitete ekonomike.

Ndërmarrje aktive – konsiderohen vetëm ato ndërmarrje që kanë deklaruar njërin nga tatimet apo ndonjë të punësuar për vitin referues

Njësi statistikore janë ndërmarrjet industriale si dhe njësite lokale të ndërmarrjeve jo industriale të cilat merren me prodhimin e produkteve të definuar sipas listës së PRODCOM -it.

Kriterium i veçantë për përfshirje në hulumtimin e PRODCOM - it është që secila klasë e industrisë (nga 05.10 deri 36.00) në NVE të mundësojë përfshirje të mjaftueshme të njësive statistikore me pjesëmarrje me së pakut 90% të vlerës së shtuar bruto të secilës klasë të industrisë. Nëse ai kriter nuk plotësohet për ndonjë klasë të NVE, atëherë përfshirja zgjerohet edhe njësi statistikore me më pakë se 10 të punësuar.

2.2 Treguesit themelorë

Tabela 1. Prodhimi dhe shitjet e realizuara sipas Listës PRODCOM-it gjatë vitit 2018

Sektori	Klasa	Kodi PRODCOM-it	Pëshkrimi produktit sipas PRODCOM - it	Njësia matëse	Vlera totale e shitur	
B	729	07291300	Nxjerrja e mineraleve jo-metalore	tonë	26937646	
	811	08111150	Nxjerrja e gurit, rërës dhe argjilës	tonë	38229123	
	1011	10113100	Përpunimi dhe konservimi (ruajtja) i mishit dhe produkteve me bazë mishi	tonë	34194610	
	1012	10121010	Përpunimi I mishit të freskët dhe të ngrirë	tonë	300368	
	1031	10311300	Përpunimi dhe konservimi i patates dhe produktevenga ajo	tonë	8981145	
	1032	10321100	Perpunimi dhe prodhimi i lëngjeve nga pemët dhe perimet	tonë	6350400	
	1039	10391100	Përpunimi dhe konzervimi tjetër I pemëve dhe perimeve	tonë	23842580	
	1041	10411100	Përpunimi i vajrave dhe yndyrnave bimore dhe shtazore	tonë	293612	
	1051	10515241	Prodhimi i produkteve të qumështit	tonë	42495426	
	1052	10521000	Prodhimi i akulloreve	tonë	891035	
	1061	10611100	Përpunimi i produkteve të drithrave, niseshtes dhe produkteve të niseshtes	tonë	36697543	
	1071	10711100	Prodhimi i produkteve të bukës, ëmbëlsirave, makaronave	tonë	23437812	
	1072	10721130	Prodhimi i kollaqeve dhe ëmbëlsirave afatgjata	tonë	4678406	
	1073	10731130	Prodhimi i makaronave dhe brumërave të ngjashme	tonë	1857782	
	1081	10811100	Prodhimi dhe përpunimi i produkteve nga sheqeri	tonë	29281	
	1082	10821100	Prodhimi i kakaos, çokolladës dhe produkteve bonbonjere	tonë	6060431	
	1083	10831130	Përpunimi i çajit dhe kafes	tonë	211037	
	C	1084	10841130	Prodhimi mëlmesave tjera për ushqim	tonë	1279964
		1085	10851100	Prodhimi ushqimit të gatshëm	tonë	182338
1089		10891100	Prodhimi produkteve tjera ushqimore	tonë	7902621	
1091		10911010	Përpunimi i ushqimeve të përgatitura për kafshë	tonë	1729262	
1101		11011020	Prodhimi i pijeve alkoolike	tonë	1202589	
1102		11021130	Prodhimi i verrës nga rrushi	tonë	5451928	
1104		11041010	Prodhimi pijeve tjera të fermentuara e të padestiluara	tonë	2919865	
1105		11051100	Prodhimi I birrës	tonë	33462125	
1107		11071130	Prodhimi pijeve freskuese, ujit mineral në shishe	tonë	61948960	
1200		12001130	Prodhimi produkteve të duhanit	tonë	449889	
1310		13101010	Përgatitja dhe endja e fijeve të tekstitit	tonë	2201133	
1330		13301110	Proceset përfundimtare të përpunimit të tekstitit	tonë	5215634	
1392		13921130	Prodhimi produkteve të gatshme nga tekstili pos veshmbathjeve	tonë	2487443	
1396		13961100	Prodhimi i tekstileve të tjera	tonë	3710945	
1412		14121120	Prodhimi i veshjeve, uniformave të punës dhe veshjeve të tjera përveç veshjeve të gëzofit	palë	4852270	
1419		14191100	Prodhimi veshjeve të tjera dhe pjesëve për veshje	palë	979816	
1511		15111030	Tanini dhe regjja e lëkurës, prodhimi i valixheve, çantave , takëmeve të kuajve dhe takëmeve të tjerë,veshja dhe ngjyrosja e gëzofit	copë	637139	
1520		15201100	Prodhimi i këpucëve	palë	5958143	
1610		16109100	Sharrimi i drurit dhe përpunimi dhe ruajtja e drurit	metër kub	4510933	
1623	16231900	Prodhimi i produkteve të drurit, zdrukhtarja dhe elemente nga druri (dritare,dyer dhe te tjera)	copë	12730616		
1629	16291200	Prodhimi produketev tjera nga druri,tavolina dhe kuzhina	copë	3399136		
1712	17121100	Prodhimi i brumit të letrës, letrës dhe kartonit	metër kub	5640926		
1721	17211100	Prodhimi i artikujve të letrës dhe kartonit	metër kub	5164686		
1722	17221210	Prodhimi produkteve për amvisëri dhe higjienë dhe të tualetit nga letra	metër kub	6194155		
1723	17231100	Prodhimi materialit për zyre nga letra	metër kub	137500		

Tabela 1. Prodhimi dhe shitjet e realizuara sipas Listës PRODCOM-it gjatë vitit 2018 (vazhdim)

Sektori	Klasa	Kodi PRODCOM-it	Pëshkrimi produktit sipas PRODCOM - it	Njësia matëse	Vlera totale e shitur
C	1729	17291120	Prodhimi produkteve tjera nga letra dhe kartoni	metër kub	1368667
	1811	18111000	Vepimtarit e shtypjes (printimit) dhe shërbimet e lidhura me shtypjen	metër kub	331228
	1812	18121230	Shërbime të shtypit të materialit propagandistik, katalogjeve komercial dhe të tjera	copë	11796936
	1813	18131000	Shërbime të përgatitjes për shtyp dhe publikim	copë	1499362
	1820	18203030	Shërbime të shumëzimit të programeve kompjuterike		8881061
	2016	20165630	Prodhimin i produkteve kimike bazë, plehrave kimike dhe komponimeve të azotit, plastikave dhe gomës sintetike në formë primare	metër kub	82210451
	2016	20165700	Silikonet në formën primare	metër kub	1643177
	2016	20165920	Përpunimi i plastikës tjetër në formën primare	metër kub	111046
	2016	20165940	Celuloza dhe derivatet tjera kimike	metër kub	3648465
	2017	20171090	Prodhimi kauçukut sintetik në formë primare	metër kub	210451
	2020	20201130	Prodhimi i pesticideve dhe produkteve të tjera agrokimike	tonë	111046
	2030	20301150	Prodhimi i ngjyrave, llaqeve dhe shtresave të ngjajshme, ngjyrë e printimit dhe mastikës	tonë	12392642
	2041	20411000	Prodhimi i sapunit dhe detergjentëve, preparatave të pastrimit dhe lustrimit	tonë	2612711
	2042	20421150	Prodhimi parfumrave dhe preparateve kozmetike dhe tualetit	tonë	58966
	2052	20521020	Prodhimi i ngjitësit	tonë	12200
	2053	20531079	Përzjerje të aromatizuesve (perfshire edhe ato per perdorim ne industrine ushqimore)	tonë	2542
	2059	20595720	Përgatitja e kyqeve për kallupe dhe produkte tjera kimike	tonë	15640
	2110	21101030	Prodhimi produkteve themelore farmaceutike	tonë	3651464
	2211	22111100	Prodhimi i produkteve të gomës	copë	883030
	2219	22191000	Prodhimi produkteve të tjera nga goma	copë	956850
	2221	22211050	Prodhimi i produkteve të plastikës ,plakave, fletëve dhe profileve	tonë	10727030
	2222	22221100	Prodhimi ambalazhit nga plastika, qeseve nga polimeretileni	copë	16605359
	2223	22231155	Prodhimi produkteve nga plastika për ndërtimtari	tonë	56408674
	2229	22291000	Prodhimi produkteve tjera nga plastika	tonë	12472354
	2312	23121150	Formëzimi qelqit të rafshët	metër katror	2253342
	2319	23191200	Prodhimi dhe përpunimi i qelqit dhe produkteve prej qelqit	metër katror	215692
	2320	23201290	Prodhimi produkteve rezistente ndaj zjarrit, bllokat tjegullat etj.	copë	2483691
	2332	23321110	Prodhimi i materialeve të ndërtimit prej argjilës	copë	15906313
	2342	23421030	Prodhimi keramikës sanitare dhe për izolim	metër kub	16235850
	2351	23511210	Prodhimi i cementit portland	metër kub	185650350
	2361	23611130	Prodhimi produkteve nga betoni për ndërtimtari	metër kub	33489529
	2362	23621050	Prodhimi produkteve nga gipsi për ndërtimtari	metër kub	496185
	2363	23631000	Përpunimi materialit të gatshëm nga betoni	metër kub	72137642
	2365	23651270	Elemente nga cementi me fije celuloze dhe të ngjashme	metër kub	13769023
	2369	23691100	Prodhimi produkteve tjera nga betoni, cementi dhe gipsi	metër kub	12865628
	2370	23701100	Thyerja e gurit, gëdhendja, dhënia e formës dhe finicioni	metër kub	52319226
	2391	23911290	Prodhimi produkteve abrazive	metër kub	15658450
	2399	23991255	Prodhimi produkteve tjera jo metalike, nga asfalti dhe materaili tjetër p.c.	metër kub	12991997
	2410	24101215	Prodhimi i hekurit dhe çelikut bazë si dhe ferrolegurave	metër kub	37647150
	2420	24201110	Prodhimi i tubave, gypave, profileve të shkrirë dhe pajisje të ngjashme, prej çeliku	metër kub	3670634

Tabela 1. Prodhimi dhe shitjet e realizuara sipas Listës PRODCOM-it gjatë vitit 2018 (vazhdim)

Sektori	Klasa	Kodi PRODCOM-it	Pëshkrimi produktit sipas PRODCOM - it	Njësia matëse	Vlera totale e shitur
	2433	24333000	Pllakëza metalike nga çeliku i tërhjekur	metër kub	361200
	2441	24411030	Prodhimi i metaleve të çmuar, argjend i papërpunuar si gjysëm produkte	metër kub	3689160
	2442	24421130	Prodhimi aluminiumit	metër kub	3483167
	2443	24431130	Prodhimi plumbit dhe zinkut	metër kub	1253405
	2444	24441100	Prodhimi bakrit, metaleve tjera te ngjyrosura	metër kub	950860
	2451	24511110	Derdhja (fonderia) e metaleve	metër kub	102998
	2453	24531010	Shkrija e metaleve të lehta	metër kub	238214
	2511	25111030	Prodhimi i produkteve të konstruksioneve metalike dhe pjesëve metalike	metër katror	76544766
	2512	25121030	Prodhimi i dyerve dhe dritareve dhe elementeve nga metali	metër katror	2789694
	2550	25501134	Farkimi, presimi, stampimi dhe palosja rrethore e metaleve, pluhuri metalurgjik	metër kub	6354480
	2561	25611130	Trajtimi dhe veshja e metaleve; përpunimi mekanik	metër kub	1583789
	2562	25622000	Shërbimet tjera të përpunimit të metaleve	copë	7184274
	2593	25931130	Prodhimi i produkteve të tjera prej metalit	tonë	1670869
	2594	25941113	Prodhimi i tapave dhe elementeve nga metali (bakri)	copë	186978
	2599	25991110	Prodhimi i produkteve të tjera prej metalit p.c.	copë	3074813
	2611	26111100	Prodhimi komponenteve elektronike	copë	1237185
	2640	26401100	Prodhimi i instrumenteve dhe pajisjeve të matjes, testimit, verifikimit dhe navigimit; orëve dhe orë të murit	copë	233944
	2670	26701100	Prodhimi instrumenteve optike	copë	292613
	2711	27111010	Prodhimi i motorëve elektrikë, gjeneratorëve, transformatorëve dhe shpërndarësve të energjisë elektrike dhe aparaturave të kontrollit	copë	347815
	2732	27321100	Prodhimi i telave dhe kablove elektronike të izolimit	metër	4084566
	2740	27401100	Prodhimi pajisjeve elektrike për ndriqim	copë	2180550
	2751	27515110	Prodhimi i frigoriferave për amvisëri	copë	3972978
	2790	27904000	Pajisje tjera elektrike	copë	2479530
	2821	28211470	Prodhimi pjesëve të ngrohësve për amvisëri p.c.	copë	264509
	2825	28252512	Prodhimi paisjeve për klimatzim	copë	1082943
	2830	28301000	Prodhimi paisjeve për bujqësi dhe pylltari	copë	8502920
	2891	28931230	Prodhimi pajisjeve për industrinë ushqimore	copë	4076039
	2932	29323010	Pjesë dhe pajisje tjera për mjete motorike	copë	1018339
	3092	30991000	Prodhimi pajisjeve tjera transportues p.c.	copë	1761966
	3101	31001250	Prodhimi karrigeve dhe pjesëve të tyre dhe pjesë të mobiljeve	Komplete	3287114
	3102	31021000	Prodhimi mobileve të kuzhinës	Komplete	94877962
	3103	31091230	Prodhimi mobileve nga druri të dhomave të fjetjes ,	Komplete	28011567
	3109	31091250	Prodhimi mobileve për qëndrim ditor dhe pjesëve të mobileve kuzhinës	Komplete	17598075
	3291	32911190	Prodhimi fshesave dhe brushave p.c	copë	1500038
	3299	32991210	Prodhimi lapsave kimik, flomastera dhe të tjera	copë	1235834
	3311	33111200	Riparimi dhe mirembajtja e pajisjeve nga metali, cisterna rezervoare etj.	copë	287339
	3312	33121990	Shërbime të riparimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve tjera për nevoja të përgjithshme	copë	55588
	3314	33141920	Shërbime të mirëmbajtjes dhe riparimit të pajisjeve elektrike: elektromotorëve, gjeneratorëve transformatorëve etj.	copë	2632334
	3317	33171100	Riparimi dhe mirembajtja e pajisjeve tjera transportuese (hekurudhore), etj.	copë	215554
	3320	33207000	Shërbime të instalimit të pajisjeve tjera p.c.	copë	14171859

Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

338.242(496.51)”2018”(048)

Statistikat e PRODCOM-it 2018 / publikimin e përgatiten Ilir T. Berisha... [et al.]. – Prishtinë : Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2019. - 14 f. : ilustr. ; 28 cm.

1. Berisha, Ilir T.

ISBN 978-9951-22-612-7

Agjencia e statistikave të Kosovës

përshkrim i shkurtër

Agjencia e statistikave të Kosovës është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

Agjencia e Statistikave të Kosovës vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011. Programi i Statistikave Zyrtare, 2013/2017 është në implementim për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

Agjencia e statistikave të Kosovës ka këtë strukturë organizative: **Departamentet prodhuese;** *Departamenti i statistikave ekonomike, Departamenti i llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit dhe Departamenti i statistikave sociale.* **Departamentet mbështetëse;** *Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim, Departamentii i Regjistrimit dhe Anketimit si dhe Departamenti i administratës.* **Ne kuadër të Agjencionit veprojnë edhe; Zyrat Rajonale;** Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj

Të punësuar janë gjithsej 159 punëtorë, prej tyre, 100 (68,0%) në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrat Rajonale, 47 (32,0%), Agjencioni ka këtë strukturë kualifikuese, 75,5% me shkollim universitar, 12,3 me shkollim të lartë, ndërsa 12,3% me shkollim të mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikatat e shteteve në rajon.

Agjencia e Statistikave të Kosovës mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njësisve raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruar terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Në vitin 2011 është realizuar me sukses projekti i Regjistrimit të Popullsisë Ekonomike Familjar dhe Banesave, ndërsa në vitin 2014 është realizuar po ashtu me sukses Regjistrimi i Bujqësisë. Rezultatet e fituara nga këto regjistrime do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

Misioni i Agjencionit; të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë, bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- **Telefoni:** +383 (0) 38 200 31 129
Kryeshefi Ekzekutiv: +383 (0) 38 200 31 112
- **Fax::** +383 (0) 38 235 033
- **E-mail:** infoask@rks-gov.net
- **Ueb-faqe:** <http://ask.rks-gov.net>

ISBN 978-9951-22-612-7



9 789951 226127